

Vlerësimi Mjedisor

RAPORTI I TË GJETURAVE NGA
HULUMTIMI I OPINIONIT



Komuna Istog



...për qytetin tim!

Vlerësimi Mjedisor

RAPORTI I TË GJETURAVE NGA HULUMTIMI I OPINIONIT



Komuna Istog

Përmbajtja

PARATHËNIE	7
PËR PROJEKTIN	8
HYRJE	9
METODOLOGJIA	10
TË GJETURAT KRYESORE PËR KOMUNËN.....	13
1. PERCEPTIMI PËR GJENDJEN E TANISHME MJEDISORE	13
1.1. Gjendja e tanishme mjedisore në territorin e komunës tuaj?	13
1.2. Pesë problemet kryesore në fushën e mjedisit në komunën tuaj?	14
1.3. Tre ndotësit kryesor të mjedisit në territorin e komunës suaj?	15
1.4. Dy institucionet që merren më së tepërmi me zgjidhjen e problemeve mjedisore?	16
1.5. Në rast se keni ndonjë problem në lidhje me mjedisinin, ku do të ishit drejtura?:	17
2. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT DHE INFORMIMIT	18
2.1. A jeni të njoftuar me ndonjë nga qëllimet e strategjisë së zhvillimit komunal?	18
2.2. A i nevojitet komunës një strategji e re zhvillimore?	19
2.3. Çka duhet të jetë bazë e zhvillimit të ardhshëm në komunën tuaj?	19
2.4. A është zhvillimi i tanishëm komunal në përputhshmëri me nevojat e juaja?.....	20
2.5. A posedon komuna personin/shërbimin që merret me mbrojtjen e mjedisit?	21
2.6. A dini ndonjë OJQ e cila maret me çështjet e mjedisore në komunën tuaj?	22
2.7. Emrat e OJQ-ve që veprojnë në komunën tuaj për mbrojtje të mjedisit:.....	22
2.8. A jeni të kënaqur me shkallën e informimit rreth gjendjes së mjedisit?	22
2.9. Nga informoheni rreth gjendjes mjedisore në komunë?	23
2.10. A mendoni se ju duhen më tepër informata rreth gjendjes së mjedisit?	24
2.11. A është e nevojshme pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje rreth mjedisit?	25
2.12. A jeni të gatshëm të bëni punë vullnetare për zgjidhjen e disa problemeve të mjedisit?	25
3. VIZIONI ZHVILLIMOR	26
3.1. Çfarë mendoni se do të jetë gjendja e mjedisit në 5 vitet e ardhshme në komunën tuaj?.....	26
3.2. Tri problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj	27
KONKLuzionET	29

PARATHËNIE

Në përputhje me Dekleratën e misionit, dhe në mbështetje të legjislacionit mjedisor vendor, Qendra Rajonale e Mjedisit- REC Zyra në Kosovë e sheh si të domosdoshme përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore qoftë në nivelin qendror edhe atë lokal.

Në këtë frymë, në kuadër të projektit për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) për Komunën tuaj, duke u mbështetur edhe në Metodologjinë e pranuar nga partnerët, REC Zyra në Kosovë ka ndërmarrë hulumtimin e opinionit publik të qytetarëve të komunës suaj, çka konkretisht qytetarët shohin si problem kryesor dhe cka propozojnë për zgjidhje.

Ky vlerësim dhe kjo përfshirje është një nga fazat më të rëndësishme të punës në procesin e hartimit të PLVM-së. Ky proces ndër të tjera ka qëllim që t'i ndihmohet edhe grupit punues komunal dhe të ekspertëve në procesin e hartimit të PLVM duke pasur për bazë edhe gjithpërfshirjen. Mbi këtë është bazuar edhe motoja e projektit PLVM...për qytetin tim!.

Mendimi i secilit në procesin e hartimit të dokumentit duhet dhe do të konsiderohet. Nga ky aspekt falënderojmë të gjithë ata qytetarë, pa dallim etnie, gjinie, profesioni e statusi shoqëror që kanë ndarë kohën e tyre për të plotësuar Pyetsorët e përgatitur. Kjo qasje është një pjesë e përgjegjësisë qytetare për mjedisin lokal por edhe një copëz pronësie e qytetarëve mbi dokumentin e PLVM së komunës respektive që do të aprovohet në fund të procesit.

REC-u si implementues i projektit është i kënaqur dhe nderuar që përmes këtij vlerësimi gjithpërfshirës, përmes Pyetsorëve kemi prekur dyert e rreth 11.000 familjeve, duke i bërë pjesëmarrës të procesit por edhe duke bërë indirekt një fushatë senzibilizimi për nevojën e përmirimit të situatës mjedisore në të mire të shëndetit dhe shoqërisë tonë.

Ky Raport, përveç për procesin e hartimit të PLVM-së mund të shfrytëzohet edhe nga institucione, ekspertë dhe hulumtues për zhvillime të metutjeshme në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm për komunën tuaj.

Në fund si implementues të projektit, REC falenderon Qeverinë suedeze dhe Sida për mbështetjen e ofruar financiare për Vlerësimin dhe Raportin si dhe projekti e PLVM-së në tërësi. Shpreh mirënjohjen time edhe për Kryetarin e Komunës, anëtarët e Grupit Punues e veçanarisht për dy koordinatorët komunal dhe të REC-ut të PLVM-së, për partneritetin e treguar në fazën e deritashme të projektit.

Një falënderim i veçantë vlen edhe për OJQ- partnere që përmes vullnetarëve të tyre kanë bërë të mundur shpërndarjen, plotësimin, mbledhjen dhe futjen e të dhënave në database, ku më tutje u përpunuan nga eksperti i angazhuar për përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e këtij Raporti z. Burim Leci.

Falënderimi më i madh, përsëri shkon për qytetarët që janë pjesë e këtij Raporti, duke ju dëshiruar suksese dhe një mjedis sa më të shëndetshëm për ju familjet dhe qytetin tuaj.

Prof. Dr. Zeqir Veselaj
Drejtor, REC Zyra në Kosovë

PËR PROJEKTIN

Qëllimi kryesor i projektit Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Qëndrueshmëri në Kosovë përqipet që të reduktoj varfërinë në Kosovë që do të arrihet duke thyer "ciklin" shterimi i burimeve / degradimi i mjedisit - Dështimin e ekonomisë - të varfërisë së zgjeruar nga zhvillimi i PLVM-ve në 10 komuna. Ky qëllim do të arrihet nëpërmjet promovimit të cilësisë më të mirë të jetës për qytetarët e sidomos për të varfëritë dhe grupet e marginalizuara, të iniciojë aktivitete ekonomike me realizimin e projekteve mjedisore që do të çojnë drejt përmirësimit të kushteve të jetesës të qëndrueshme.

Projekti i propozuar ndihmon zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të institucioneve lokale në Kosovë për planifikimin e qëndrueshmërisë dhe menaxhimin duke adresuar çështjet e minimizimit të degradimit të mjedisit, të decentralizimit, fuqizimin e institucioneve vendore, duke e zvogëluar efektet negative të ndërrimeve në strukturat politike, duke rritur shpejtësinë e reformave institucionale. Kjo është në një vijë me kërkesat e decentralizimit dhe regjionalizimit si qëllimet e reformave të parashikuara në negociata dhe / ose marrëveshjeve për përafrimin e Kosovës me BE-në.

Objektivat e projektit të PLVM-së korrespondojnë direkt me synimet më të gjera të Programit REC për Mbështetje e Nismave Lokale në Evropën Juglindore. Ky projekt është financuar nga Sida dhe realizuar nga REC me komunat partnere si përfitues. Objektivat e projektit gjithashtu korrespondojnë me prioritetet e investimeve të rekomanduara për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (siç paraqitet në grafikun më sipër) dhe përgjigjet në dështimet e qeverisjes dhe fushat specifike të politikës neglizhuse², si dy nga katër çështjet që njihen si arsye për mangësitë në arritjen e MDGs³.

Objektiva 1: Përmirësimi i planifikimit mjedisor

Ky projekt i njeh të dyja, kërkesat ligjore në komunat përfituese dhe nevojat e shprehura nga përfaqësuesit e komunave dhe palët e interesuara vendore siç është shkruar në dokumentin Konkluzionet e Përbashkët të miratuar në konferencën rajonale "Udhërrëfyesit për Qëndrueshmërinë Lokale në Evropën Juglindore" në Beçej 2006, të vazhdojë të punojë në zhvillimin e PLVM-ve . Ky projekt do të udhëheq 10 komuna të Kosovës për të ngritur kapacitetet lokale dhe nacionale në përmirësimin e praktikave të planifikimit mjedisore.

Objektiva 2: Ofrimi i investimeve mjedisore

Projekti do të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për projektet prioritare lokale me bashkëfinancim të parashikuar nga komunat përfituese. Fokus shtesë i investimeve të lidhura me aktivitetet do të jetë identifikimi i mënyrave më të mira të mundshme të përfshirjes së burimeve të financimit në dispozicion lokale dhe nacionale (p.sh. nacionale eko-fondet dhe të tjerët) në PLVM-të e zhvilluara në komunitetet përfituese. Kjo në mënyrë efektive kontribuon në qëndrueshmërinë financiare të komuniteteve lokale dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të tyre

Objektiva 3: Përmirësimin e menaxhimit mjedisor

Ndihma e drejtpërdrejtë në menaxhimin mjedisor është identifikuar si një nga faktorët kyç për fuqizimin e njerëzve të varfër dhe përmirësimin e kushteve, sidomos në komunat me minoritete, vendbanimet e marginalizuara dhe komunat e mëdha me sfidat më të mëdha urbane dhe zhvillimit të pabarabartë të lagjeve. Ujë më të mirë, higjienë, dhe infrastrukturë për menaxhimin e mbeturinave, sistemet e mbrojtjes nga ndotja dhe integrimi i strategjive sektoriale lokale janë të nevojshme në komunitete lokale në Kosovë

HYRJE

Me qëllim që hartimi i Planeve Lokale të Veprimit në Mjedis të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të merr në konsideratë opinionin e qytetarëve mbi çështjet e ndryshme mjedisore, gjatë muajit nëntor të vitit 2011 është realizuar hulumtimi në teren me 10 komuna të përzgjedhura për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM). Komunitat të cilat kanë shprehur interes dhe janë përzgjedhura që të hartojnë PLVM-në janë: Fushë Kosova, Mitrovica, Deçani, Hani i Elezit, Graçanica, Istogu, Obiliqi, Juniku, Podujeva dhe Parteshi.

Të gjeturat nga ky hulumtim fillimisht do të jenë në dispozicion të grupeve punuese nëpër komunitat e përzgjedhura për hartimin e PLVM-së, në mënyrë që të marrin në konsideratë opinionin e qytetarëve nga komuna përkatëse. Të gjeturat e hulumtimit do të ndihmojnë anëtarët e grupeve punuese që të trajtojnë tema të ndryshme gjatë hartimit të PLVM-ve, apo të forcojnë argumentet e tyre gjatë përzgjedhjes së pozicionimeve të ndryshme në PLVM.

Hulumtimi në terren është realizuar nga organizatat joqeveritare mjedisore të cilat veprojnë në komunitat e përzgjedhura për hartimin e PLVM-së. Gjatë hulumtimit në terren anëtarët e organizatave joqeveritare përpos që kanë intervistuar respondentët në bazë të shpërndarjes së mostrës, ata edhe i kanë informuar qytetarët për rëndësinë e PLVM-së, dhe mundësinë e dhënies së kontributit të tyre në hartimin e PLVM-së. Për këtë arsye, realizimi i hulumtimit në terren, ka rezultuar me informim të drejtpërdrejtë prej më tepër se 11.000 respondentëve të përzgjedhur (qytetarëve të intervistuar) për të marrë pjesë në hulumtim. Të dhënat e mbledhura në terren, më pas janë proceduar në programin kompjuterik SPSS, i cili është program i specializuar për nxjerrjen rezultateve nga hulumtimet kuantitative sociale.

Gjetjet e hulumtimit janë të prezantuara në kapitullin e të gjeturave kryesore dhe janë të ndara për çdo komunë. Të gjeturat për çdo komunë janë të ndara si në vazhdim: *perceptimi për gjendjen e tanishme mjedisore, strategjia e zhvillimit dhe informimit si dhe vizioni zhvillimor.*

METODOLOGJIA

Qendra Regjionale e Mjedisit zyra në Kosovë (REC), për të realizuar këtë hulumtim në teren ka angazhuar organizatat joqeveritare mjedisore të cilat veprojnë në komunat e përzgjedhura për hartimin e PLVM-së. Roli i organizatave të angazhuara ka qenë që të intervistojnë respondentët, t'i bartin të dhënat e hulumtimit tek koordinatori i hulumtimit, si dhe të informojnë të intervistuarit shkurtimisht në lidhje me PLVM-në.

Para se të filloj hulumtimi në teren, REC-u ka organizuar trajnim një ditor për hulumtuesit, të cilët janë përzgjedhur nga organizatat joqeveritare përgjegjëse për realizimin e hulumtimit në teren. Në këtë trajnim është shpjeguar përmbajtja e pyetësorit; mënyra e administrimit të pyetësorit; mënyra e intervistimit; shpërndarja e mostrës dhe rëndësia e respektimit të përpiktë të saj; konfidencialiteti dhe kodi etik gjatë intervistimit.

Hulumtimi është realizuar në dhjetë komuna të përzgjedhura për hartimin e PLVM-ve. Numri i respondentëve për komuna është përzgjedhur në bazë të regjistrimit të popullsisë, realizuar gjatë pranverës së vitit 2011 (shih tabelën e më poshtme për ndarjen e numrit të respondentëve për komuna). Më tej, mostra e respondentëve është ndarë në bazë të gjinisë dhe në bazë të grupmoshave. Ndarja në mes të gjinive është bërë në bazë të të dhënave nga regjistrimi i fundit i popullsisë, ndërsa ndarja në grupmosha është bërë duke marr për bazë numrin e popullsisë që korrespondon me grupmoshën përkatëse si dhe statusin e tyre social, ekonomik dhe politik në të tashmen dhe të ardhmen e afërt. Ndarja e numrit të respondentëve në mes të gjinisë dhe grupmoshave është paraqitur në tabelën në vijim.

	Gjinia	Meshkuj					Femra				
		gr. mosha nr. i respod.	>18 10%	18-25 20%	25-50 43%	50-65 20%	65+ 7%	>18 10%	18-25 20%	25-50 43%	50-65 20%
1 Deçan	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16
2 Fushë Kosovë	2000	102	204	442	204	68	98	196	425	196	65
Fushë Kosovë (ALB - 85%)	1700	87	173	376	173	58	83	167	361	167	55
Fushë Kosovë (MIN - 15%)	300	15	31	66	31	10	15	29	64	29	10
3 Graçanicë	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16
Graçanicë (SRB - 90%)	450	23	46	99	46	15	22	44	96	44	15
Graçanicë (MIN - 10%)	50	3	5	11	5	2	2	5	11	5	2
4 Hani i Elezit	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16
5 Istog	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16
Istog (ALB - 95%)	475	24	48	105	48	16	23	47	101	47	16
Istog (MIN - 5%)	25	1	3	6	3	1	1	2	5	2	1
6 Junik	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16
7 Mitrovicë	3500	179	357	773	357	119	172	343	743	343	114
Mitrovicë (ALB - 80%)	2800	143	286	619	286	95	137	274	594	274	91
Mitrovicë (MIN - 20%)	700	36	71	155	71	24	34	69	149	69	23
8 Obiliq	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16
Obiliq (ALB - 90%)	450	23	46	99	46	15	22	44	96	44	15
Obiliq (MIN - 10%)	50	3	5	11	5	2	2	5	11	5	2
9 Partesh	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16
10 Podujevë	2000	102	204	442	204	68	98	196	425	196	65
Podujevë (ALB - 95%)	1900	97	194	420	194	65	93	186	403	186	62
Podujevë (Min - 5%)	100	5	10	22	10	3	5	10	21	10	3
Nr i respondentëve	11000	561	1122	2431	1122	374	539	1078	2335	1078	359

Respondentët apo qytetarët e intervistuar janë përzgjedhur me metodën e rastit d.m.th për secilën pikënisje, çdo i treti person është ftuar për intervistë apo në çdo të dytën shtëpi është trokitur për

intervistë. Respondentët kanë pasur mundësinë që të japin (apo mos të japin) të dhënat e tyre për t'u informuar rreth hartimit të PLVM-së në komunën e tyre. Këto të dhëna kanë shërbyer edhe për të kontrolluar cilësinë e hulumtimit në teren. Një numër i konsideruar i të anketuarve, të cilët kanë lënë në dispozicion kontaktet e tyre, janë kontaktuar për të vërtetuar vlefshmërinë e hulumtimit në teren – me shpërndarjen e mostrës dhe kështu me këtë kontroll të cilësisë është arritur vlefshmëria e hulumtimit. Pas mbledhjes së të dhënave në teren, pyetësorët janë administruar në programin kompjuterik të quajtur SPSS dhe janë gjeneruar të dhënat dhe grafikët për përgjigjet e dhëna nga respondentët.

SHËNIM:

Grafikët dhe tabelat në pyetjet me numër rendor (1.2.), (1.3.), (1.4.), (2.3.), (2.9.) dhe (3.1.)¹ në total japin një përqindje më të lartë se 100 %. Kjo është si rrjedhojë e fuzionimit të të dhënave nga më tepër se një tabelë apo grafik në një tabelë apo grafik të vetëm. Në këtë mënyrë është mundësuar që të nxirret në mënyrë të saktë prioriteti i çështjeve të ndryshme për pyetjet në fjalë. Kjo do të thotë, se për pyetjen (1.2) në vend që të paraqiten pesë tabela dhe grafikë të ndryshëm ato janë të shprehura me një grafik dhe tabelë të vetme – e cila mundëson leximin sa më të lehtë të të gjeturave nga lexuesit e raportit.

¹ 1.2. Pesë problemet kryesore në fushën e mjedisit në komunën tuaj; 1.3. Tre ndotësit kryesor të mjedisit në territorin e komunës tuaj; 1.4. Dy institucionet që merren më së tepërmi me zgjidhjen e problemeve në fushën e mjedisit; 2.3. Çka duhet të jetë baza e zhvillimit të ardhshëm në komunën tuaj?; 2.9. Nga informoheni rreth gjendjes mjedisore në komunë?; 3.1. Rrumbullakosni 3 problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj

Istog

SHPËRNDARJA E MOSTRËS PËR KOMUNËN E ISTOGUT

Komuna	Gjinia # i resp.	Meshkuj (51%)					Femra (49%)				
		>18 10%	18-25 20%	25-50 43%	50-65 20%	65+ 7%	>18 10%	18-25 20%	25-50 43%	50-65 20%	65+ 7%
Istog	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16
Istog (ALB - 95%)	475	24	48	105	48	16	23	47	101	47	16
Istog (MIN - 5%)	25	1	3	6	3	1	1	2	5	2	1



Për realizit të këtij hulumtimi në pjesët urbane të Istogut janë intervistuar 500 respondent, ku prej tyre 95 % kanë qenë shqipëtarë dhe 5 % nga radhët e minoritetëve. Kjo shpërndarje e mostrës është ndarë tutje në aspektin gjinor: 51 % meshkuj dhe 49 %, ndarje e bazuar në të dhënat e rexhistrimit të popullsisë të realizuar gjatë pranverës së vitit 2011. Ndarja e mostrës ka filluar tutje të shpërndahet nëpër grupmosha, si për meshkuj ashtu edhe për femra: 10 % e respondentëve kanë përbërë grupmoshën nën 18 vjeç; 20 % për grupmoshën 18 deri në 25 vjeç; 43 % për grupmoshën 25 deri në 50 vjeç; 20 % për grupmoshën 50 deri në 65 vjeç; si dhe 7 % për grupmoshën mbi 65 vjeç. Kjo ndarje në grupmosha është bazuar në numrin e respondentëve që përbëjnë në atë grupmosh, ndikimin dhe reflektimin që kanë në jetën sociale, politike dhe ekonomike, si dhe ndikimin dhe reflektimin që mund të kenë në të ardhmen e afërt.

1. PËRCEPTIMI PËR GJENDJEN E TANISHME NJEDISORE

1.1. Gjendja e tanishme mjedisore në territorin e komunës e tuaj

		e mirë	e kënaqshme	e pakënaqshme	nuk e di
Gjinia	Mashkull	63	68	121	3
		24.7%	26.7%	47.5%	1.2%
	Femer	72	59	109	4
		29.5%	24.2%	44.7%	1.6%
Total		135	127	230	7
		27.1%	25.5%	46.1%	1.4%

Në pyetjen se si e vlerësoni gjendjen e tanishme mjedisore në territorin e komunës tuaj, shumica e respondentëve nga Istogu janë përgjegjur se: gjendja në territorin e komunës së tyre është e pakëndshme me gjithsej 46.1%, e mirë me 27.1%, si dhe e kënaqshme me 25.5%. Kjo përgjigje nuk varion tepër kur krahasohet në mes të dy gjinive, për më tepër shih ilustrimin në grafet e më poshtme.



1.2. Pese problemet kryesore në fushën e mjedisit në komunën tuaj



Gjinia	Mashkull	zhurma	mbeturinat e grumbulluara komunale	ujërat e zeza / kanalizimet	mungesa e shërbimeve komunale	rrugët jo të mira lokale, shtigjet, mungesa e parkingjeve	mungesa e informata ve dhe transparenca	mos mirëmbajtja e zonave të gjelbra, parqeve dhe shiritave mbrojtës	
								mbrojtja e pasurive dhe vlerave natyrore	
		102	175	167	69	91	95	108	91
		20.4%	35.0%	33.4%	13.8%	18.2%	19.0%	21.6%	18.2%
	Femer	103	171	144	87	64	96	110	82
		20.6%	34.2%	28.8%	17.4%	12.8%	19.2%	22.0%	16.4%
Total		205	346	311	156	155	191	218	173
		41.0%	69.2%	62.2%	31.2%	31.0%	38.2%	43.6%	34.6%

Si problem kryesore mjedisore qytetarët nga Istogu kanë listuar⁸:

- Menaxhimi e mbeturinave komunale**, si problemin kryesor
- Ujrat e zeza/kanalizimet**, si problemin e dytë më të rëndësishëm
- Ciësia e ujit të pijshëm**, si problemin e tretë më të rëndësishëm
- Mos mirëmbajtja e zonave të gjelbra, parqeve dhe shiritave mbrojtës**, si problemin e katërt më të rëndësishëm, si dhe
- Zhurma**, është renditur si problem i pestë për nga rëndësia.

Edhe në këtë rast rënditja e problemeve mjedisore nuk ka ndryshuar për nga perceptioni gjinor, për ilustrim shih grafet në vazhdim.

⁸ **SHËNIM:** Grafet dhe tabelat në pyetjet me numër rëndor (1.2), (1.3), (1.4.), (2.3), (2.9) dhe (3.1) ⁸ në total japin një përqindje më të lartë se 100 përqind. Kjo është si rrjedhojë e fuzionimit të të dhënave nga më tepër se një tabelë apo graf në një tabelë apo graf të vetëm. Në këtë mënyrë është mundësuar që të nxierret në mënyrë të saktë prioritetimi i qështjeve të ndryshme për pyetjet në fjalë. Kjo do të thotë, se për pyetjen (1.2) në vend që të paraqiten pesë tabela dhe grafe të ndryshme ato janë të shprehura me një grafë dhe tabelë të vetme – e cila mundëson leximin sa më të lehtë të të gjeturave nga lexuesit e raportit.




Si probleme tjera të theksuara nga qytetarët e Istogut janë: Prerja apo dëmtimi i pyejeve dhe ndezja e zjarreve – qoftë për pastrim të arave apo mbeturinave tjera.

1.3. Tre ndotësit kryesor të mjedisit në territorin e komunës tuaj

		ekonomia e vogël	kanalizimi	mbeturinat komunale	trafiku
Gjinia	Mashkull	79	214	193	151
		15.8%	42.8%	38.6%	30.2%
	Femer	79	208	180	144
		15.8%	41.6%	36.0%	28.8%
Total		158	422	373	295
		31.6%	84.4%	74.6%	59.0%

Si ndotës kryesor mjedisor në komunës e *Istogut* respondentët kanë paraqitur: **kanalizimin**, **mbeturinat komunale** dhe **trafikun**. Kjo ndarje nuk varion tepër në aspektin gjinor, për më tepër shih paraqitjen grafike.





Probleme tjera të theksuara nga respondentët si ndotës të mjedisit janë: djegja e mbeturinave, gjeneratorët, gurthyesit dhe vetë njeriu.

1.4. Dy institucionet që merren me se tepërmi me zgjidhjen e problemeve në fushën e mjedisit

		qeveria komunale	ndërmarrjet publike komunale (ujë, mbeturina, kanalizim, gjelbrim)	mjetet lokale të informimit	organizatat joqeveritare ose shoqëria civile	qytetarët	askush
Gjinia	Mashkull	174	171	6	20	41	27
		34.8%	34.2%	1.2%	4.0%	8.2%	5.4%
	Femer	159	146	9	20	48	30
		31.8%	29.2%	1.8%	4.0%	9.6%	6.0%
Total		333	317	15	40	89	57
		66.6%	63.4%	3.0%	8.0%	17.8%	11.4%



Respondentët nga *Istogut* më se tepërmi mbështetën tek **qeveria komunale** në zgjedhje të problemve në fushën e mjedisit, kurse si alternativë të dytë zgjedhin **ndërmarrjet publike komunale**. Për më tepër shih ilustrimin grafik.



1.5. Në rast se personalisht keni ndonjë problem që është në lidhje me mjedis, për zgjidhjen e këtij problemi së pari do të ishit drejtuar tek

		zyra komunale kompetente për mjedis (ose zyrtarit komunal për mjedis)	inspektoriati komunal	ndërmarrja publike komunale	organizata joqeveritare	mjetet lokale të informimit	policia
Gjinia	Mashkull	195	26	19	2	1	6
		78.3%	10.4%	7.6%	.8%	.4%	2.4%
	Femer	198	19	16	1	3	4
		82.2%	7.9%	6.6%	.4%	1.2%	1.7%
Total		393	45	35	3	4	10
		80.2%	9.2%	7.1%	.6%	.8%	2.0%

Për problemet individuale mjedisore qytetarët e *Istogut* fillimisht do të drejtoheshin tek **zyra komunale kompetente për mjedis**, dhe më pas tek **inspektoriati komunal**. Shih ilustrimin grafik në vijim.





2. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT DHE INFORMIMIT

2.1. A jeni të njoftuar me ndonjë nga qëllimet e strategjisë së zhvillimit komunal?

		PO	JO	nuk e di a ekziston diçka e tillë
Gjinia	Mashkull	20	191	44
		7.8%	74.9%	17.3%
	Femer	18	179	47
		7.3%	73.1%	19.2%
Total		38	370	91
		7.6%	74.0%	18.2%


Shumica e qytetarëve të intervistuar të *Istogut* janë shprehur se nuk janë të njoftuar me qëllimet e strategjisë së zhvillimit komunal me 74.0%; apo nuk janë në dijeni se ekziston diçka e tillë me 18.2%; përderisa vetëm 7.6% shprehen se janë në dijeni mbi qëllimet e strategjisë së zhvillimit komunal. Për ilustrim shih grafet e më poshtme.



2.2. A i nevojitet komunës një strategji e re zhvillimore?

		PO	JO	nuk e di a ekziston diçka e tillë
Gjinia	Mashkull	243	4	8
		95.3%	1.6%	3.1%
	Femer	232	7	5
		95.1%	2.9%	2.0%
Total		475	11	13
		95.2%	2.2%	2.6%

Në pyetjen se a i nevojitet komunës së *Istogut* një strategji e re zhvillimore, shumica e qytetarëve të intervistuar janë shprehur se po i nevojitet me 95.2%, nuk i nevojitet me 2.2%, dhe se nuk e dinë se a ekziston diçka e tillë me 2.6%. Sa i përket kësaj pyetje si femrat ashtu edhe meshkujt kanë pikëpamje pothuajse të njejtë. Për më tepër shih ilustrimin në vazhdim.




2.3. Çka duhet të jetë bazë e zhvillimit të ardhshëm të komunës suaj?

		industria	zejtaria	bujqësia	turizmi	prodhimi i produkteve ekologjikisht të pastra	gjuetia dhe peshkimi
Gjinia	Mashkull	107	55	183	119	22	6
		21.4%	11.0%	36.6%	23.8%	4.4%	1.2%
	Femer	97	69	162	119	15	7
		19.4%	13.8%	32.4%	23.8%	3.0%	1.4%
Total		204	124	345	238	37	13
		40.8%	24.8%	69.0%	47.6%	7.4%	2.6%

Si bazë për zhvillimit të ardhshëm të *Istogut*, qytetarët e intervistuar listojnë:

- i) **Bujqësinë,**
- ii) **Industrinë,**
- iii) **Turizmin,** e të të tjera.



Shih ilustrimin grafik për rëndësinë e dhënë, nga të intervistuarit, për fushat bazë për zhvillim të komunës së tyre në të ardhmën.



2.4. A është zhvillimi i tanishëm komunal në përputhshmëri me nevojat e juaja?

		PO	shumë pak	Jo
Gjinia	Mashkull	53	135	67
		20.8%	52.9%	26.3%
	Femer	45	139	61
		18.4%	56.7%	24.9%
Total		98	274	128
		19.6%	54.8%	25.6%



Shumica e qytetarëve të intervistuar, shprehin se zhvillimi i tanishëm i *Istogut* nuk përkon me nevojat e qytetarëve: 54.8% shprehne se *shumë pak* zhvillimi i tanishëm komunal i përshtatet nevojave të tyre, 25.6% nuk i përkon me nevojat e tyre, përderi sa 19.6% mendojnë se zhvillimi komunal është në harmoni me nevojat e qytetarëve. Shih grafet në vijim për ilustrim vizuel.



2.5. A posedon komuna personin/shërbimin që merret me mbrojtjen e mjedisit?

		PO	JO	Nuk di
Gjinia	Mashkull	43 16.9%	25 9.8%	187 73.3%
	Femer	41 16.7%	24 9.8%	180 73.5%
Total		84 16.8%	49 9.8%	367 73.4%



Një numër i konsideruar i qytetarëve të intervistuar, nuk janë në dijeni se komuna e *Istogut* posedon personin apo shërbimin që merret me mbrojtjen e mjedisit. Në përqindje 16.8% janë shprehur se komuna posedon personin apo shërbimin që merret me mbrojtje të mjedisit, 9.8% shprehen që komuna nuk e ka këtë shërbim, ndërsa 73.4% nuk e dijnë se a e posedon komuna këtë shërbim. Shih grafet në vijim për ilustrim.



2.6. A dini ndonjë organizatë joqeveritare e cila në mënyre aktive është duke u marrë me çështjet e mbrojtjes së mjedisit në territorin e komunës suaj?

		PO	JO
Gjinia	Mashkull	32	222
		12.5%	87.1%
	Femer	14	231
		5.7%	94.3%
Total		46	453
		9.2%	90.6%

Shumica e qytetarëve të intervistuar nga *Istogu* nuk janë në dijeni për ekzistencën apo veprimtarinë e organizatave të shoqërisë civile që meren me çështjet e mbrojtjes së mjedisit. Në përqindje 90.6% janë shprehur se nuk ekzistojnë organizata të tilla në territorin e komunës së tyre.





2.7. Emrat e organizatave që njohin respondentët në komunën e tyre:

Kryqi I kuq, Iliria-I, Vizioni 2 dhe Mirëmbajtja

2.8. A jeni të kënaqur me shkallën e informimit rreth gjendjes së mjedisit në territorin e komunës suaj?

		po	në përgjithësi	shumë pak	jo	nuk e di se informohet për këtë
Gjinia	Mashkull	10	38	117	79	11
		3.9%	14.9%	45.9%	31.0%	4.3%
	Femer	11	46	117	68	3
		4.5%	18.8%	47.8%	27.8%	1.2%
Total		21	84	234	147	14
		4.2%	16.8%	46.8%	29.4%	2.8%



Nga të gjeturat e hulumtimit qytetarët e intervistuar të *Istogut* në përgjithësi nuk janë të kënaqur me shkallën e informimit rreth gjendjes mjedisore në komunën e tyre. Për këtë 29.4% janë përgjigjur se nuk janë fare të kënaqur me shkallën e informimit, 46.8% shumë pak të kënaqur, 16.8% në përgjithësi të kënaqur, për deri sa vetëm 4.2% janë shprehur se janë të kënaqur me shkallën e informimit. Për ilustrim shih grafet në vijim.



2.9. Nga informoheni rreth gjendjes mjedisore në komunë?

		gazetat ditore	radio stacionet	televizionet	organet kompetente komunale	tjetër (shënori)
Gjinia	Mashkull	125	208	115	60	33
		25.0%	41.6%	23.0%	12.0%	6.6%
	Femer	125	201	92	55	19
		25.0%	40.2%	18.4%	11.0%	3.8%
Total		250	409	207	115	52
		50.0%	81.8%	41.4%	23.0%	10.4%

Si medime të informimit për gjendjen mjedisore, qytetarët e intervistuar të *Istogut*, kanë përzgjedhur **radio stacionet** si mediumin **primar**, **gazetat ditore** si mediumin **sekondar**, dhe **televizionin** si mediumin **terciar**. Për ilustrim vizuel shih grafet në vijim.





Si burime tjera të informacionit për gjendjen mjedisore, qytetarët e istogut përdorin edhe: interneti, bashkë qytetarët, OJQ-të, observimi personal dhe shkolla.

2.10. A mendoni se ju duhen më shumë informata rreth gjendjes së mjedisit në territorin e komunës suaj?

		po	jo	nuk e di
Gjinia	Mashkull	251	2	2
		98.4%	.8%	.8%
Gjinia	Femer	241	3	1
		98.4%	1.2%	.4%
Total		492	5	3
		98.4%	1.0%	.6%


Shumica e qytetarëve të intervistuar të *Istogut*, në pyetjen se a ju duhen më tepër informata rreth gjendjes mjedisore në territorin e komunës tuaj? me 98.4% janë shprehur se kanë nevojë për më tepër informata për gjendjen mjedisore në komunën e tyre. Kjo përgjigje nuk varion tepër mes respondentëve meshkuj dhe femra. Për ilustrim shih grafet në vijim.



2.11. A është e nevojshme pjesëmarrja drejtpërdrejtë më e madhe e qytetarëve në vendimmarrje rreth mjedisit?

		po	jo	nuk e di
Gjinia	Mashkull	242	1	12
		94.9%	.4%	4.7%
	Femer	232	3	9
		95.1%	1.2%	3.7%
Total		474	4	21
		95.0%	.8%	4.2%



Shumica e konsideruar e qytetarëve të intervistuar të *Istogut*, janë shprehur se pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në proceset e vendimmarrëse është e nevojshme. E shprehur në përqindje 95.0% shprehen se pjesëmarrja është e nevojshme. Kjo përqindje nuk varion teper mes respondentëve meshkuj dhe femra, për ilustrim grafik shih grafet në vazhdim.



2.12. A jeni të gatshëm që vullnetarisht të përfshiheni në punë në zgjidhjen e disa nga problemeve komunale të mjedisit?

		po	jo	nuk e di
Gjinia	Mashkull	215	23	17
		84.3%	9.0%	6.7%
	Femer	211	23	11
		86.1%	9.4%	4.5%
Total		426	46	28
		85.2%	9.2%	5.6%

Nga të gjeturat e hulumtimit, qytetarët e *Istogut* janë të gatshëm që të angazhohen vullnetarisht në zgjedhjen e disa nga problemeve mjedisore në komunitetin e tyre. Një përqindje e lartë prej 85.2% janë të gatshëm që të bëjnë punë vullnetare; 5.6% nuk e dine se a do të angazhoheshin kurse 9.2% nuk do të angazhoheshin në punë vullnetare. Për dallim prej qyteteve tjera, gatdismëria e femrave për punë vullnetare në Istog, është pak më i lartë se sa gadishmëria e meshkujve. Për ilustrim shih grafet e më poshtme.





3. VIZIONI ZHVILLIMOR

3.1. Çfarë mendoni se do të jetë gjendja e mjedist në 5 vjetët e ardhshme në territorin e komunës suaj?

		më e mirë	e njëjtë	më e keqe	nuk e di
Gjinia	Mashkull	215	25	5	10
		84.3%	9.8%	2.0%	3.9%
Femer		202	34	1	7
		82.8%	13.9%	.4%	2.9%
Total		417	59	6	17
		83.6%	11.8%	1.2%	3.4%

Shumica e qytetarëve të intervistuar në *Istog*, janë optimist sa i përket gjendjes së ardhshme mjedisore. Në pyetjen, se çfar mendoni se do të jetë gjendja mjedisore në pesë (5) vitet e ardhshme në territorin e komunës suaj? Shumica e responentëve janë përgjigjur se do të jetë *më e mirë* me 83.6%, *e njëjtë* 11.8%, si dhe *nuk e di* me 3.4%. Pothujase mendimin e njëjtë ndajnë si femrat ashtu edhe meshkujt, për ilustrim shih tabelat e poshtë shënuara.





3.2. Rrumbullakësoni 3 problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj?

		1. zhurma	2. deponitë e mbeturinave komunale mbeturinat	3. ujërat e zeza	4. cilësia e ujit në kanale ose lumjenjë	7. rrugët e këqija lokale apo mungesa e parkingjeve,	9. përdorimi i pakontrolluar i tokës bujqësore,
Gjinia	Mashkull	70 14.0%	89 17.8%	125 25.0%	92 18.4%	76 15.2%	51 10.2%
	Femer	71 14.2%	103 20.6%	106 21.2%	86 17.2%	64 12.8%	62 12.4%
Total		141 28.2%	192 38.4%	231 46.2%	178 35.6%	140 28.0%	113 22.6%

Në pyetjen se cilat janë tri problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj, responentët nga *Istogu* kanë përzgjedhur:

- i) **Ujrat e zeza**, si problemin e parë
- ii) **Deponitë e mbeturinave komunale**, si problemin e dytë, dhe
- iii) **Cilësia e ujit në kanale ose lumjenjë**, si problemin e tretë.

Për më tepër shih ilustrimet grafike mbi problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen e tyre:



KONKLUZIONET

Shumica e të gjeturave nga hulumtimi e rikonfirmojnë përshtypjen tonë për problemet e ndryshme mjedisore që ekzistojnë nëpër komunat përkatëse. Megjithatë, çdo komunë dallohet për nga veçoritë e tyre mjedisore, si për shembull, Hani i Elezit, Obiliqi dhe Fushë Kosova problem primar e kanë ajrin e ndotur e për këto tri komunat është më se i ditur shkaktari i ndotjes së ajrit. Përderisa komunat tjera nuk e kanë këtë si problem primar.

Në pjesën për *perceptimin e gjendjes së tanishme mjedisore*, për të gjitha komunat përgjigjja e respondentëve është se gjendja e tanishme mjedisore nuk është e mirë dhe kjo lenë të nënkuptohet se duhet të punohet në përmirësimin e gjendjes mjedisore. Për këtë respondentët e shohin qeverinë lokale, ndërmarrjet publike komunale si dhe vetë qytetarët përgjegjës për të përmirësuar gjendjen mjedisore në territorin e komunës së tyre. Varësisht prej komunave, disa prej problemeve që kërkojnë adresim të menjëhershëm janë: *Menaxhimi i mbeturinave komunale, Ujërat e zeza/kanalizimet, Cilësia e ujit të pijshëm, Mos mirëmbajtja e zonave të gjelbra, parqeve dhe shiritave mbrojtës, Zhurma, Cilësia e ujit në lumenj dhe kanale, Mungesa informative dhe transparencë, Përdorimi i pakontrolluar i tokës bujqësore, Mungesa e shërbimeve komunale, Cilësia e ajrit, Ujërat e ndotura industriale*, si dhe problem tjera.

Në pjesën për *strategjinë e zhvillimit dhe informimit*, shumica e respondentëve të anketuar janë shprehur se nuk janë të informuar me qëllimet e strategjisë së zhvillimit komunal; komuna e tyre ka nevojë për një strategji të re zhvillimore dhe se zhvillimet e tanishme nuk përkojnë me nevojat e qytetarëve. Për këtë arsye administrata komunale duhet të zhvilloj një platformë të komunikimit me qytetarët e saj dhe të përfshijë ata në proceset e vendimmarrjes – në këtë rast në hartimin e PLVM-së. Nga hulumtimi është konfirmuar që qytetarët kryesisht informatat i marrin nga televizioni, radiot lokale, shtypi ditor dhe interneti. Këto medime do të duhej të ishin kanale përmes të cilave informohen qytetarët. Megjithatë, respondentët kanë përzgjedhur edhe kanale tjera të informimit të cilat janë specifike për komunat përkatëse.

Qytetarët e anketuar, shumë pak kanë njohuri rreth organizatave mjedisore që veprojnë në komunat përkatëse apo edhe për shërbimin komunal që merret me çështjet mjedisore. Për këtë organizatat mjedisore, si dhe shërbimi komunal për mjedis, duhen të jenë më prezentë me aktivitetet e tyre në komunitet si dhe më të zëshme në adresimin e problemeve mjedisore. Fakti më i vërtetuar me këtë hulumtim është se shumica e të anketuarve janë të gatshëm të bëjnë punë vullnetare për çështje mjedisore, me qëllim të përmirësimit të mjedisit në lagjet e tyre. Ky fakt do të duhej të përdoret nga organizatat jo-qeveritare mjedisore si dhe nga autoritet komunale për të pasur qytetarët aleat në veprimet mjedisore.

Në pjesën për *vizionin zhvillimor*, shumica e të anketuarve shpresojnë se në të ardhmen gjendja e mjedisit do të ndryshojë për të mirë. Kjo pritshmëri mund të arrihet me hartimin e PLVM-ve dhe jetësimin e tyre në praktikë, mirëpo çdo herë duke i informuar drejtë dhe duke i përfshirë qytetarët dhe grupet e interesit në proceset e vendimmarrjes.



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER



Republika e Kosovës
Ministria e MMPH dhe MAPI

